

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Frontera Medical & SPA Durres” SHPK

Sot më date 04.03.2025 ne, te nenshkruarit:

Virgjil Nini, i biri i Spiros, i datëlindjes 25/11/1960, banues në Durrës, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. G01125052D

Diana Nini, e datëlindjes 15/04/1969, banuese në Durrës, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. G95415201V

Pjesa e përgjithshme

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, hartojmë këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “Frontera Medical & SPA Durres” dhe emrin tregtar “Frontera Medical & SPA Durres”. Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare “Frontera Medical & SPA Durres”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qëndrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar do të ketë seline e saj qëndrore në Lagja nr. 1, Rruga Taulantia, Godine me numer pasurie 25/115-N4, Zona Kadastrale 8512, Durres.

3.2 Ndryshimi i zyrës qëndrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë:

Qendër estetike dhe parukeri. Sallon SPA e shërbime nderlidhese. Masazhe, shërbime dhe trajtime

estetike, relaksi. Të zhvillojë kurse të formimit profesional për mbarëvajtjen dhe specializimin e punonjësve nga ana estetike, profesionale, teknike, etj., si dhe kurse të formimit profesional në fushën e estetikës, Parukerise, make-up, hair style, manikyr dhe pedikyr.

Tregti i produkteve të parfumerise dhe kozmetikës, produkteve të ndryshme të bukurisë e të estetikës, kremra të ndryshëm, shampo, aromatizues të llojeve të ndryshme, , produkte të higjenës, produkte ushqimore të bukurisë, të trajtimit të lëkurës, detergjentë të llojeve të ndryshme, produkte hotelerie, artikujve të konsumit të gjere, etj. Import dhe eksport i produkteve të sipershenuara, të kozmetikës, etj

Tregtimi, Importimi dhe eksportimi i çdo produkti apo malli i çfaredolloj natyre, importimi dhe eksportimi i çdo lloj makinerie, e pajisje që është i nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë së sipërmendur.

Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pakufizuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimin e shoqërisë dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e parshlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar SHPK është 100.000 (njëqindmije) Leke, e ndarë në 1 kuotë, i cili është nënshkruar nga ortaku i vetëm.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Z. Virgjil Nini është ortaku i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, të barabartë me 50% të kapitalit të shoqërisë në vlerën 50.000 leke.

- Znj. Diana Nini është ortaku i shoqërisë, e cila zotëron 1 kuotë, të barabartë me 50% të kapitalit të shoqërisë në vlerën 50.000 leke.

NENI 9

Organet e shoqërisë

9.1 Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

NENI 10

Administratori

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

Administratori i shoqërisë është Znj. Diana Nini për një periudhë 5-Vjecare.

NENI 11

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.

ORTAKËT THEMELUES

Virgjit Nini

Diana Nini